

BIBLIOTEKA E

85H-93-32


776

SHALLS

GJIROKASTER

TOMKA

NASHO JORGAQI



8SH-93-32

8SH-93-32

J 76 Biblioteka e Pionierit S

NASHO V. JORGAQI

T O M K A

(TREGIME)

~~47187~~

1262.

BIBLIOTEKA E SHETËTIT
GJUDOKESH

SHËTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

TOMKA

Sa djalë i mirë ka qenë Tomka! Ju nuk e kini njohur Tomkën dhe s'kishit si ta njihnit. Po unë që e kam patur shok të vegjëlisë, e mbaj mend fort mirë, sikur ta kisha tani para syve.

Tomka ishte një djalë në moshën tuaj, i gjatë e i hollë si cingël, me kokë të qethur toç, me një ballë të gjerë e me ca sy të mëdhenj që i xixëllonin.

Ne ishim atëhere shokë të ngushtë. Ishte kohë lufte. Vendi që mbushur plot me njerëz të liq, me fashistë e tradhëtarë. Ata shtypnin popullin, vrisnin njerëzit e mirë, digjnin shtëpitë, mbyllnin shkollat. Fashistët kishin pushuar atëhere gjithë Shqipërinë, Kishin ardhur dhe në lagjen tonë e na kishin zënë sheshin ku loznim. Një ditë përpara, ne luajtëm me top lecke deri sa u err, po të nesërmen kur u ngritëm e shkuam në fushë, nuk njohëm fu-

shën tonë. Fërkonim sytë dhe shikonim. Ajo nxinte nga topat, nga maqinat e çadrat, nëpër fushë lëvrinin njerëz të panjohur. Ca ushtarë, me kapele hekuri në kokë, rrethonin fushën me tela. Atje ku ne kishim portën kur loznim, fashistët kishin vendosur një roje me pushkë. Ne vështronim fushën tonë dhe na vinte të qanim nga inati. Atëhere Tomka, tha:

— S'ka gjë, çuna! Fusha, e jona është...

Dhe ne, që atë ditë, megjithëse fushën na e kishin zënë, nuk largoheshim që andej. Silleshim aty rrotull ose loznim me top në rrugën ngjitur me fushën. Këtë e bënim, jo se fusha do të na ikte ose do të na e rrëmbenin, po se si na vinte ta linim vetëm. Pastaj, donim t'u tregonim fashistëve se s'ua kishim frikën.

Ne loznim me top lecke para syve të rojes gjermane. Ai lëvizte me pushkë në krah në hyrje të fushës me tela. Bashkë me të, bënte roje edhe një qen i madh leshator e me turi si të ujkut. Në fillim, ne nuk ja dinim emrin qenit, por një ditë dëgjuam rojen që i thirri:

— Gof!

Se si ishte ky emër: Gof! Të vinte për të qeshur! Ky Gofi nuk rrinte në një vend, bridhte sa andej këtej, lehte sa herë t'i tekej, frikësonte fëmijët, ishte tamam qen fashist. Ne e kishim shumë inat atë qen. Bile, gjithë ina-



tin që kishim për fashistët, donim t'ja shfrenim Gofit. Dhe, kur e shihnim prapa kampit të gjermanëve ose në ndonjë hendek, e qëllonim fshehurazi me gur e pastaj iknim me vrap ose hidheshim nga muri në kopshtin e xha Ndonit.

Ne loznim pothuaj çdo ditë me top lecke në rrugën tonë ngjitur me fushën. Andej kalonin maqina gjermane, lëviznin karro, vinin e iknin ushtarë. Gofi futej në mes nesh, gjasme donte të na trembte, po prapë ne s'donim t'ja dinim. Loznim e i bënim gola njëri-tjetrit, bërtisnim e vraponim gjersa vinte mbrëmja e na thërrisnin prindërit. Por, qëllonte nganjëherë që ndonjëri prej nesh i binte topit fort dhe topi shkonte nga fusha e mbetej sipër ndonjë çadre gjermane. Ne atëhere zemëroheshim keq me shokun tonë, po nuk e bënim veten në sy të rojes. As topin nuk shkonim t'ua kërkonim gjermanëve. Nuk donim t'u luteshim fashistëve. Punë e madhe për një top!

I pari largohej Tomka. Ai fshinte me mëngën e xhakëtës ballin e djersitur dhe thoshte: — Hajdeni, çuna, ikim!

Dhe ne, pa bërë fjalë, shkonim pas tij, të mërzitur që e kishim lënë lojën përgjysëm. Tomka ishte kryetari ynë, dhe ne e dëgjonim fjalën e tij. Megjithëse nuk e kishim zgjedhur,

TOMKA

Sa djalë i mirë ka qenë Tomka! Ju nuk e kini njohur Tomkën dhe s'kishit si ta njihnit. Po unë që e kam patur shok të vegjëlisë, e mbaj mend fort mirë, sikur ta kisha tani para syve.

Tomka ishte një djalë në moshën tuaj, i gjatë e i hollë si cingël, me kokë të qethur toç, me një ballë të gjerë e me ca sy të mëdhenj që i xixëllonin.

Ne ishim atëhere shokë të ngushtë. Ishte kohë lufte. Vendi që mbushur plot me njerëz të liq, me fashistë e tradhëtarë. Ata shtypnin popullin, vrisnin njerëzit e mirë, digjnin shtëpitë, mbyllnin shkollat. Fashistët kishin pushuar atëhere gjithë Shqipërinë, Kishin ardhur dhe në lagjen tonë e na kishin zënë sheshin ku loznim. Një ditë përpara, ne luajtëm me top lecke deri sa u err, po të nesërmen kur u ngritëm e shkuam në fushë, nuk njohëm fu-

shën tonë. Fërkonim sytë dhe shikonim. Ajo nxinte nga topat, nga maqinat e çadrat, nëpër fushë lëvrinin njerëz të panjohur. Ca ushtarë, me kapele hekuri në kokë, rrethonin fushën me tela. Atje ku ne kishim portën kur loznim, fashistët kishin vendosur një roje me pushkë. Ne vështronim fushën tonë dhe na vinte të qanim nga inati. Atëhere Tomka, tha:

— S'ka gjë, çuna! Fusha, e jona është. . .

Dhe ne, që atë ditë, megjithëse fushën na e kishin zënë, nuk largoheshim që andej. Sillehim aty rrotull ose loznim me top në rrugën ngjitur me fushën. Këtë e bënim, jo se fusha do të na ikte ose do të na e rrëmbenin, po se si na vinte ta linim vetëm. Pastaj, donim t'u tregonim fashistëve se s'ua kishim frikën.

Ne loznim me top lecke para syve të rojes gjermane. Ai lëvizte me pushkë në krah në hyrje të fushës me tela. Bashkë me të, bënte roje edhe një qen i madh leshator e me turi si të ujkut. Në fillim, ne nuk ja dinim emrin qenit, por një ditë dëgjuam rojen që i thirri:

— Gof!

Se si ishte ky emër: Gof! Të vinte për të qeshur! Ky Gofi nuk rrinte në një vend, bridhte sa andej këtej, lehte sa herë t'i tekej, frikësonte fëmijët, ishte tamam qen fashist. Ne e kishim shumë inat atë qen. Bile, gjithë ina-




tin që kishim për fashistët, donim t'ja shfrenim Gofit. Dhe, kur e shihnim prapa kampit të gjermanëve ose në ndonjë hendek, e qëllonim fshehurazi me gur e pastaj iknim me vrap ose hidheshim nga muri në kopshtin e xha Ndonit.

Ne loznim pothuaj çdo ditë me top lecke në rrugën tonë ngjitur me fushën. Andej kalonin maqina gjermane, lëviznin karro, vinin e iknin ushtarë. Gofi futej në mes nesh, gjasme donte të na trembte, po prapë ne s'donim t'ja dinim. Loznim e i bënim gola njëri-tjetrit, bërtisnim e vraponim gjersa vinte mbrëmja e na thërrisnin prindërit. Por, qëllonte nganjëherë që ndonjëri prej nesh i binte topit fort dhe topi shkonte nga fusha e mbetej sipër ndonjë çadre gjermane. Ne atëhere zemëroheshim keq me shokun tonë, po nuk e bënim veten në sy të rojes. As topin nuk shkonim t'ua kërkonim gjermanëve. Nuk donim t'u luteshim fashistëve. Punë e madhe për një top!

I pari largohej Tomka. Ai fshinte me mëngën e xhakëtës ballin e djersitur dhe thoshte:
— Hajdeni, çuna, ikim!

Dhe ne, pa bërë fjalë, shkonim pas tij, të mërzitur që e kishim lënë lojën përgjysëm. Tomka ishte kryetari ynë, dhe ne e dëgjonim fjalën e tij. Megjithëse nuk e kishim zgjedhur,



mencën, ata mezi prisnin të shikonin armët e artiljerëve.

Sa herë i kishin parë nga larg grykat e topave, që ngriheshin drejt qiellit! Dhe sa dëshirë kishin t'i shikonin nga afër!

Tani ata qenë pranë tyre, i shikonin tek vetëtinin, i preknin me dorë, u lëviznin instrumentët, dëgjonin fjalët e ushtarëve.

— Ky është topi im! — i tha Novruzi Aliut, me zë të ulët.

— Pse s'thua yni? — ja priti Aliu.

— Si the? — pyeti komisari.

— Ne duam të mësojmë topin, — tha Aliu më në fund, duke shikuar nga shokët, që heshtën papritur. — Në gazetë kemi lexuar për fëmijët e qytetit, që kanë qëlluar me top.

— Edhe ju do ta mësoni, — tha komisari, — po me një kusht: do të bëhen artiljerë vetëm ata që shkojnë mirë me mësim.

Djemtë sa nuk ju hodhën në qafë oficerit. Vetëm Fatmiri uli kokën. Komisari e vuri re, po nuk bëri zë. As të tjerët nuk thanë gjë për shokun e tyre.

— Ne, — ja bëri Aliu, — do të jemi edhe nxënës edhe ushtarë të mirë.

— Vetëm duhet të pranoni një gabim, — tha komisari.

Fëmijët hapën sytë. Ushtarët që rrinin përçark, buzëqeshën.

Komisari i hodhi një vështrim serioz Aliut e tha:

— Ushtarë sot nuk janë vetëm djemtë, po dhe vajzat.

Djemtë panë njëri-tjetrin në sy. Vetëm Aliu vazhdonte të shihte oficerin dhe, kur ai mbaroi, tha:

— Shoku komisar, ne ju premtojmë se herën tjetër do të vijmë bashkë me shoqet!

Kështu mori fund vizita e parë e fëmijëve në repart.

Të nesërmen, komisar, bashkë me komandantin, oficer Perlatin, shkuan në shkollë dhe, pas disa ditësh, një grup djemsh e vajzash ju ngjit kodrës duke kënduar.

Ata i ndanë në skuadra dhe secilës skuadër i dhanë nga një top të vogël.

Ndërkaq, filloi stërvitja. Djemtë e vajzat mësonin të fshehtat e armës, bënin prova, lëviznin instrumentët, drejtonin topin.

Stërvitja vazhdoi me javë e me muaj të tërë, deri sa erdhi dita e qitjeve.

Kjo ishte një ditë gëzimi për të gjithë.

U mbledh i tërë fshati në fushën që quhej poligon. Erdhën prindërit, vëllezërit, motrat, mësuesit dhe shokët e tyre ushtarë.

Artiljerët e vegjël qëndronin pranë armëve dhe prisnin urdhër. Komisari i shikonte dhe u buzëqeshte.

U dëgjuan komandat dhe, fill pas tyre, zërat e artiljerëve të vegjël.

Qielli jehoi, toka u tund, dhe predhat e zjarra fluturuan në vendet e caktuara.

Pastaj u bë heshtje. Të gjithë prisnin përfundimet, kur vendi kumboi nga thirrjet e gëzuara të fëmijëve.

Artiljerët e vegjël kishin qëlluar në she-një.

Armiku qe asgjësuar.

Komisari dhe fëmijët përqafoheshin të mallëngjyer.

prapë ai ishte komandanti ynë. Ne e donim të gjithë Tomkën. Ai qe më trimi e më i forti nga të tërë çunat e lagjes. Tomka ishte i drejtë, nuk mbante hatër, s'gënjente kurrë, dhe ne i besonim atij për shumë gjëra. Pastaj, ai kish edhe një vëlla partizan. Ne të tjerët i kishim vëllezërit të vegjël. Vetëm Raqi kish një vëlla të madh, po ai s'kish dalë partizan.

Në shtëpinë e Tomkës, herë pas here, vinin njerëz të panjohur. . . Ata rrinin gjithnjë brenda dhe rrallë dilnin në oborr. Një ditë, kur unë e Raqi shkuam të kërkonim Tomkën në shtëpi, takuam një burrë të huaj. Ai ishte i gjatë, me mustaqe, kishte veshur një triko të kuqe. Sapo na pa, buzëqeshi e na përkëdheli nga koka.

— Tomkën doni?

— Tomkën! — i thamë ne me gjysëm zëri, kokulur, duke e shikuar me bisht të syrit.

— Prisni, se tani vjen!

Ai u kthye për në dhomë, ndërsa ne, atë çast, vumë re se, prapa xhakëtës, burri më triko të kuqe kishte revole.

Kur erdhi Tomka, Raqi e pyeti:

— Kush është ai burri?

Tomkës nuk i erdhi mirë kjo pyetje, prandaj u vrejti e tha:

— Një kushëri i babit!

Qe e para herë që Tomka nuk po na thoshte të vërtetën, po unë e Raqi nuk u zemëruam. Ashtu ishte puna!

Ne vazhdonim të loznim gjithnjë me top në rrugë, po ai Gofi na binte në qafë. Dilte nga kampi i të zotërve, fuste turinin nëpër plehrat e hendeqeve, bënte ndonjë shëtitje andej rrotull dhe, papritur, gjendej në mes tonë e na prishte lojën. Kjo gjë ndodhte shpesh, po njëherë, kur ishim në kulmin e ndeshjes, Gofi i prishi Vaskës një gol të sigurtë. Atëhere Vaska rrëmbeu një gur e desh ta qëllonte. Në atë kohë, roja e pa që larg dhe thirri fort, në një gjuhë, që neve na u duk si e lehur:

— Auuuu!...

Vaska uli dorën që kish ngritur lart dhe vështroi nga roja plot zemërim. Guri i qe bërë grusht në dorë. Ne të tjerët kishim qëndruar në vend, pa ditur ç'të bënim. Si gjithnjë, dhe kësaj radhe Tomka foli i pari:

— Mos e ndërprisni lojën, çuna. Ku është topi?

Topi kish rënë në hendek, dhe unë shko-va e ja gjuajta Tomkës.

Nisëm përsëri nga loja. Vaska priti topin që i gjuajti Tomka. Po gurin e mbante ende shtrënguar në dorë. Ne loznim, gjuanim sa andej-këtej, por Gofi rrinte ngulur në mes të

rrugës, si ta bënte kastile. Ne e kuptonim se ai rrinte për sherr, dhe përpiqeshim të mos e ngacmonim.

Kështu, ne luajtëm atë ditë deri sa mbaruam lojën. Po Gofi, kur e pa që ne s'e përfillëm fare, u grrit e iku para nesh.

Gofi ishte bërë i padurueshëm. Na e kish sjellë në majë të hundës. Vaska tha të merrnim llastiqe dhe ta qëllonim të gjithë së bashku. Ai, me siguri, në qoftë se s'do të ngordhte, do të plagosej rëndë. Po Tomka nuk desh dhe nuk na e tha arësyeën. Ai tha një gjë tjetër:

— Çuna, nuk i numërojmë njëherë sa maqina e topa ka në fushë.

— Ohu, dhe ti, — u hodh Raqi, — ç'na duhen ato!..

Tomka vuri buzën në gaz dhe më shkeli syrin.

— I numërojmë, — tha Vaska. — Ne kemi numëruar dhe yjet... .

Po kjo nuk ishte punë e kollajtë, sepse ato nuk numëroheshin dot nga rruga. Duhej të hipnim diku për të parë gjithë fushën. Menduam njëherë të ngjiteshim nëpër shtyllat e telefonit, po shtyllat ishin anës rrugës dhe binin në sy. Deshëm të shkonim në taracën e shtëpisë së lartë të Ali Beut, po ai ishte ballist dhe s'futeshe dot. Atëhere, vendosëm të ngji-

teshim në arrën e madhe të kopshtit të Xha Ndonit, që binte karshi fushës. Dhe kështu bë-
më. Pa humbur kohë, kaluam murin e kop-
shtit dhe u ngjitëm njëri pas tjetrit në arrën
e lartë. Që andej, fusha dukej si në pëllëmbë
të dorës. Po në fillim, ne nuk e njohëm fushën
tonë, aq shumë kish ndryshuar: e kishin çarë
e prishur nga të katër anët. Kishin hapur hen-
deqe e gropa, kishin derdhur ujë, kishin ngu-
lur shtylla. Si që bërë ashtu gjithë ajo fushë
e bukur! Ne e shikonim e s'flisnim. Përbrenda
na ziente inati dhe na vinte t'i qëllonim që
andej fashistët me gurë.

— Hë, — ja bëri Raqi, — ç'më rrini si
gallofa!

Atëhere, ne filluam nga puna, zumë të
numërojmë me radhë çadrat, maqinat, topat.
Raqi numëronte, duke bërë me dorë.

— Jo ashtu, — tha Tomka, — se të shi-
kon roja.

Ne i numëruam disa herë, deri sa u bin-
dëm për numrin e tyre. Pastaj zbritëm dhe u
shpërndamë, të gëzuar se kishim kryer një de-
tyrë. Tomka atë ditë shkoi drejt e në shtëpi.
Që prej asaj dite, ne e prisnim Tomkën me
gëzim. Ai na ngarkonte me disa gjëra, për të
cilat më parë as që na shkonte mendja.

Tomka thoshte:

— Shikoni kur vjen e kur ikën ajo maqina e komandantit gjerman.

— Cili ballist hyn në kampin e fashistëve?

— Kush e gjen se sa ushtarë gjermanë janë në fushë?

Ne i kryenim me qejf këto detyra dhe shkonim e ja tregonim Tomkës.

Po detyra më e bukur dhe më e vështira ishte ajo e fundit.

Ne u takuam atë pasdite te çezma: Ishim: unë, Tomka dhe Vaska. E kishim lënë me fjalë që në mëngjez, po nuk e dinim se ç'do të bënim. Bile, as Tomka nuk dinte gjë. Kur u takuam, vura re se njëri xhep i xhakëtës së Tomkës ishte i fryrë.

— Ç'ke në xhep? — e pyeta.

— Mish.

— Mish?!

— Po, e kam marrë për Gofin, — tha Tomka.

Unë e Vaska hapëm sytë të habitur: si do t'i jepte mish Gofit kur s'kishim as për vete? Pastaj, kujt do t'i jepte mish? Gofit!

— Pse talle? — tha Vaska.

— Unë s'tallem, Gofit do t'ja jap.

— Po pse, është bërë i mirë Gofi?

— Jo, tashti është i keq, por, po t'i japim këtë copë mishi, bëhet i mirë.

Unë e Vaska ende nuk po kuptonim gjë.
Tomka qeshi.

— Hajdeni, — tha ai duke ecur, — se nuk kemi kohë. Duhet t'ja japim Gofit para se të hajë darkë se, po hëngri darkë, nuk e ha pastaj.

Ne kaluam disa rrugica dhe dolëm në rrugën e fushës. Atë kohë po perëndonte dielli. Nga larg vinte zhurma e mullirit të Taqos. Një motoçikletë gjermane kaloi me vrull. Roja, si gjithnjë, qëndronte në hyrje të fushës. Ai na kish kthyer kurrizin dhe nuk na shihet tek vinim. Ne shikonim me kujdes rrugën, hendekun, kampin, pa folur me njëri-tjetrin. Kur po afroheshim, Tomka tha:

— E shihni gjë Gofin?

— Jo!

— Ku dreqin ka shkuar?!

Tomka qëndroi dhe na e bëri me shenjë. Ne vajtëm e u ulëm sipër ca drurëve që ishin hedhur anës rrugës. Atje ndenjëm e pritëm. Nuk di sa pritëm deri sa doli Gofi. Ai kapërceu portën dalëngadalë, me kokën ulur, pastaj qëndroi para rojes, u fërkua pas tij dhe ndenji aty një kohë. Neve na vinte inat. Ai nuk lëvizte fare nga vendi dhe kushedi sa do të qëndronte ashtu, po të mos kish hyrë një maqinë në kamp. Kur maqina u afrua, ai luajti nga vendi dhe kaloi në hendek. Maqina ndaloi pak


te roja, ndërsa ne u ngritëm dhe ndoqëm qenin nga pas. Ai u çapit ngadalë nëpër hendek deri sa doli prapa kampit. Tashti roja nuk mund të shikonte as qenin dhe as ne. Gofi qëndroi dhe u ul ndenjtur në bisht. Ai rrinte dhe na shikonte, me veshë të rënë mbi fytyrë. Asnjëherë nuk e kishim parë Gofin kaq afër. Gofi kish ca sy të turbullt, me rrema të kuq, si sytë e pijanecëve, dhe nuk di se ç'donte të thoshte me atë vështrim.

— Ti Vaskë, — tha Tomka, — shih nga roja.

Vaska bëri disa hapa nga rruga dhe u ul në hendek. Unë rrija në vend.

— Ti merr me kujdes një gur, — tha Tomka, — dhe prit.

Unë bëra ashtu si tha Tomka, ndërsa ai ju afrua Gofit me mishin në dorë. E dija që Tomka ishte guximtar, po që t'i shkonte qenit gjerman pa frikë fare, këtë se kisha marrë me mend. Ai seç i pëshpëriti diçka Gofit, po qeni s'levizi nga vendi. Shikonte mishin në dorë të Tomkës dhe rrinte i qetë. Tomka ja afroi edhe më shumë dorën, dhe copa e mishit preku turirin e qenit. Gofi u ngrit në këmbë duke tundur bishtin e shkurtër. Unë u tremba pak, po Tomka i fishkëlleu me zë të ulët. Gofi nxori gjuhën e kuqe jashtë. Tomka e largoi copën dhe filloi



ta ndjellë duke u larguar. Përsëri qeni nuk e mori mishin. Atëhere Tomka e hodhi mishin përtokë. Gofi u çapit dhe vajti sipër copës së mishit. Ndenji ashtu një çast duke i marrë erë, e pastaj hapi gojën. Mua më rrahu zemra fort, kurse Tomka e shikonte qenin me vëmendje se ç'bënte. Gofi e futi menjëherë copën e mishit në gojën e madhe dhe e mbajti ashtu një grimë pa lëvizur nofullat.

— Ikim? — thashë unë.

— Prit! — ja pat Tomka. — S'e ka ngrënë ende.

Nuk kaloi shumë, dhe Gofi filloi ta gëlltiste mishin. Pastaj mori të ecë andej nga kish-te ardhur, ndërsa Tomka e ndoqi nga pas deri te kthesa. Atje, papritur, Gofi zuri të vrapojë nëpër hendek.

— Largohu që aty, Vaskë! — tha Tomka.

Vaska erdhi te unë. Ne rrinim në këmbë dhe prisnim urdhërin e kryetarit tonë. Ai shikonte me kujdes Gofin tek largohej. Papritur, ne dëgjuam që qeni gulçoi, pastaj lehu si me të qarë e s'u ndje më.

Unë e Vaska shikonim njëri-tjetrin në sy. Vaska ende s'kish kuptuar se ç'kish ndodhur, po kur u kthye Tomka dhe dolëm në rrugicën e shtëpisë sime, atëhere mori vesh si kish qënë puna.

— Gofi na mori të keqen! — tha i gëzuar Tomka.

— Pse? — pyeti Vaska.

— Nuk e more vesh ti se ç'bëmë ne sonte? E helmuam!

Atë natë vonë, në kampin e gjermanëve plasën bomba dhe u dogjën disa çadra. Nga dritarja e shtëpisë, unë shikoja flakën që ngrihej lart në qiell, dhe përplasja duart nga gëzimi. Mamaja më shikonte me habi, po ajo nuk e dinte se unë me Tomkën e Vaskën kishim vrarë qenin-roje të fashistëve. Gjithë qyteti u gëzua atë natë nga aksioni i guximshëm i partizanëve. Po njerëzit nuk e dinin se në këtë gjë kishim ndihmuar dhe ne të vegjlit.

Kjo ishte detyra e fundit që kryem me Tomkën, sepse, pas disa ditësh, babai e nëna e tij dolën partizanë dhe morën edhe Tomkën me vete.



БИБЛИОТЕКА СМЕТЛИ
ГИРОНАСЕР

47187

1262.

POROSIA E PARTISË

Nëna thirri nga kuzhina:

— Fatos, ore Fatos, ç'trazon atje?

Unë rrëmbeva gërshërët e mëdha dhe i futa me të shpejtë në thesin që kisha marrë me vete. Kur dëgjova hapat e saj në koridor, e lashë thesin në një qoshe të qilarit të errët dhe dola që andej me aq vrull, sa për pak u rrezova. Atë çast, bëri ballë nëna.

— Të kam thënë njëqind herë, — tha ajo, — mos më hyrë në qilar, se më tremb kllोक-
kën!

Unë ula kokën që të mos më shihte në fytyrë dhe pëshpërita:

— Nuk ishte kllोकka...

— Po ti, ç'deshe atje? — ma ndërpreu fjalën ajo, e zemëruar.

— Kërkoja topin, — thashë unë.

— Ku e ke topin? — thirri ajo duke më vështruar me vërejtje.

Mua, papritur, m'u lidh gjuha e nuk dija ç't'i përgjigjesha. Ajo më kapi prej dore dhe më pyeti:

— Hë, ç'ke ndërmend të bësh sot? Prapë me ato gjëra?!

Unë ngrita kokën, ndërsa sytë ja ngula derës gjysmë të hapur të koridorit. Ndjeja se nëna po më shikonte e shqetësuar. Mbetëm një çast në heshtje. Pastaj ajo filloi të arësye-tonte me zë të ulët:

— Ti e shikon që murgeshat i kemi afër. Ato dreqkat janë të gjitha spiune të fashistëve. Do të na vënë zjarrin ndonjë ditë. . .

Mua s'm'u durua. Ndjeva që gjaku më hipi në fytyrë dhe s'e përmbajta dot veten.

— Le ta provojnë po ua mbajti, — ja prita gjithë duf. — Për kokën e babait, ua hedh bombën mu mbi çati.

Nëna këtë desh dhe, sa dëgjoi këto fjalë, m'u sul me të lutura e qortime. Më tha se isha i vogël, dhe se ato ishin punë për të mëdhenjtë. . . Pastaj më hodhi dorën në qafë duke më parë gjithnjë në sy.

— Ti do të bësh ndonjë gjë sot, e shoh unë, — tha ajo. Ç'ke ndërmend të bësh?

Në vend që t'i përgjigjesha, unë qesha dhe zura të vërshëllej. Nëna kishte ndërmend të bisedonte ende, po ndërkaq trokiti porta. Be-

fas, sytë e saj morën një hije të lehtë. Ajo pëshpëriti:

— Rri ti Fatos, se po dal unë .

Zbriti shkallët dhe doli jashtë. Unë këtë desha, të isha i lirë! Nëna hapi portën. Një fshatar, që tërhiqte një gomar ngarkuar me dru, hyri në oborr. Ata seç biseduan dhe pastaj shkuan të dy për nga oborri i pasmë. S'prita më, po rrëmbeva thesin në qilar, e hodha në krahë dhe vrapova jashtë portës. Më të dalë, dëgjova zërin e nënës:

— Fatos, ore Fatos!

Po unë nuk e ndala hapin, as kokën s'e ktheva. Megjithatë, padashur, më erdhi keq që e shqetësoja ashtu nënën. Por, një ditë do ta kuptonte që unë po kryeja punë të mira.

Ishte mbrëmje e nxehtë korriku, sa kish rënë muzgu i parë. Kur dola në krye të rrugicës së shtëpisë sime, ngadalësova hapin, hoqa thesin nga krahu dhe e mora në dorë. Ecja zbathur dhe ndjeja nën këmbë pluhurin e vakët të asaj mbrëmjeje vere. Nga fusha e druve vinin zërat e çunave që loznin cingël. Dëgjoja si thërrisnin hareshëm e plot zhurmë, po prapë s'kisha qejf të shkoja te ata. Unë e disa shokë të mi bënim ca punë, që ishin me rrezik të madh: shpërndanim trakete, kishim shpuar dy herë gomat e automobilëve të fashistëve,

kishim rrëmbyer një kasetë me municion në fushën e aeroplanëve, ishim bërë specialistë për t'u marrë oficerëve nga prapa revolverët. Këtë të fundit e bënim zakonisht në kinema, kur njerëzit shtyheshin për të hyrë, ose brenda, kur shuheshin dritat. Ndërsa kësaj here, shoku Misto na kish ngarkuar një detyrë tjetër, që nuk na kish shkuar në mendje. Këtë na e tha në bahçen e Hasanit, ku ishim mbledhur gjoja për të ngrënë fiq. Shoku Misto na tha se Partia kërkonte prej nesh që të prisnim telat e telefonit të armikut. Kur tha kështu, të gjithë lëvizëm nga vendi të gëzuar. Ishte qejf i madh të prisje telat e telefonit. Ato i kishim kudo sipër kokës dhe një punë të tillë mund ta bënim kollaj. Shoku Misto sikur e kuptoi mendimin tonë dhe mori një pamje serioze:

— Jo, djema, — tha ai, — nuk është punë kaq e lehtë sa mund të kujtoni ju.

Pastaj, na tregoi se si duhej bërë kjo punë, ç'masa duheshin marrë dhe ç'vegla do të përdroreshin. Na këshilloi të ishim sa më të kujdesshëm dhe ta bënim çdo gjë me fshehtësinë më të madhe. Në fund, shoku Misto na ndau detyrat. Mua dhe Aliut na ra të prisnim telat në lagjen tonë.

— Ku mendoni ta kryeni aksionin? — më pyeti ai.

— Unë them, shoku Misto, që telin fa-
shistëve t'ua presim te caraca e nënë Ishes.

— Mirë e ke menduar, — vërejti ai. —
Ajo ka dhe djalin partizan në Pezë. Këtë ak-
sion do ta bëni bashkë me Aliun.

Kjo kishte ndodhur para dy ditësh. Tani
unë po shkoja të kryeja detyrën. Me Aliun, siç
e kishim lënë me fjalë, u takuam te porta e
shtëpisë së tij.

Ecnim seriozë, pa folur, sikur të ishim të
mëdhenj. Aliu ishte i gjatë, flokëzi e vetull-
trashë, dhe ajo hije e rëndë sikur i shkonte,
kurse unë, me atë trup të shkurtër e fytyrë të
imtë, kushedi se si dukesha. Po prapë nuk e
jepja veten: e hidhja hapin serbes dhe më vin-
te keq që nuk kisha këpucë, siç kishte Aliu,
që ta dëgjoja zhurmën e hapave të mia. Aliu
e kishte të fryrë gjoksin, dhe unë e kuptova
pse e kishte ashtu, prandaj i thashë me zë të
ulët:

— Bjere ta fusim në thes.


— Jo, jo, — tha ai, — mirë e kam.

— Gërshërë i ke? — e pyeta.

— Jo, sharrë hekuri. E mora fshehurazi
në dyqanin e dajës.

— Ç'e deshe kot! — ja bëra unë.

— Po teli me sharrë hekuri pritet, — tha
Aliu.



— Ç'ne! Teli do gërshërë, ja si këto që kam unë këtu, — dhe i tregova thesin.

Aliu qeshi e tha:

— Gërshërët duan duar burri. Ku kemi ne aq fuqi!

Kjo gjë nuk më kish shkuar ndërmend, po prapë nuk e thashë. Heshtëm një copë herë dhe pastaj, sikur të kisha zbuluar ndonjë gjë të re, gati sa s'thirra:

— Sharra bën zhurmë!

Aliu ktheu kokën i vrenjtur. E kuptova se i kish ardhur keq.

— Mirë, mirë, — ja bëri ftohtë ai. — Do ta provojmë atje!

Ne s'folëm një copë rrugë. Ecnim dhe vështronim me kujdes përçark. Atë kohë njerëzit po ktheheshin për në shtëpi, po asnjëri nuk e dinte se ç'kishim ndërmend të bënim. Kjo na nxiste ta ndjenim më fort detyrën, aq më tepër që këtë aksion do ta kryenim në mes të lagjes sonë.

Ne e njihnim lagjen me pëllëmbë, i njihnim njerëzit gati emër për emër, e dinim se populli ishte me partizanët, e të pasurit me fashizmin. Kishim hypur në çdo mur, ishim ngjitur në të gjitha pemët. I dinim tërë dyert e deriçkat, të hyrat e të dalat e brendshme. Bile, kishim shpëtuar dhe një shok të njësitit gue-

ril, që kish bërë një atentat dhe që fshehur në lagjen tonë. Këtë e dinte dhe shoku Misto. Prandaj, e ndjeja zemrën të ngrohtë, sepse, sido që të ndodhte, ishim në lagjen tonë dhe do të dinim si të manovronim.

— Babi! — thirri Aliu me zë të ulët. Ai menjëherë vrapoi dhe u fsheh prapa portës së doktor Petros. Unë i shkova pas dhe qëndruam një çast aty duke pritur në heshtje. Babai i Aliut po kthehej nga puna, i lodhur e i raskapitur, me një bostan nën sqetull. Shokut tim i rrihte zemra fort. Kur babai kaloi, dolëm nga porta dhe ecëm më tutje.

Gjithë rrugës nuk folëm. Mendonim vetëm për aksionin që na priste.

Nënë Ishja po rrinte ulur në hajatin e hapur dhe po arronte. Llamba e elektrikut varej nën trarët e zinj të shtëpisë.

Ne u afruam me ndrojtje dhe e përshëndetëm.

— Mirëmbërëma, çuna! — tha ajo dhe vu-ri dorën si strehë, që të na shihte më mirë.
— Hë, ç'kemi?

Ne të dy u pamë në sy.

— Do të hipim pak në caracë, — i thashë unë. Ajo uli kokën dhe vazhdoi të arronte. Ne qëndronim ende në këmbë.

— Mirë, mor çuna, — tha nënë Ishja, — po kujdes, se tani është natë!

Ndërsa ajo fliste, unë shikoja telat e telefonit, që kalonin mbi shtëpi dhe shkonin mbrapa saj, ku gjendej caraca. Aliu më tërhoqi për krahu, ndërsa dëgjova që tha:

— Faleminderit!

— Faleminderit! — përsërita unë dhe, të kapur prej dore, vrapuam prapa shtëpisë. Caraca e nënë Ishes ishte e vjetër dhe kishte marrë shumë përpjetë. Gjethet i kishin rënë, dhe ajo ngrihej si një skelet i zi sipër shtëpisë përdhese.

— Ngjitemi? — ja bëri Aliu duke mbajtur sytë lart.

— Prit të errësohet dhe njëçikë, — i thashë. — Si na tha shoku Misto?

Ne rrinim nën caracë duke u munduar të shquanim në errësirën e zbehtë të asaj mbrëmjeje vere telin që kalonte sipër saj.

— Kaloka keq, dreqi i telit! — foli Aliu, sikur të ishim të një mendjeje.

— S'ka gjë, — ja prita. — Hipi unë, se jam më i lehtë e më mban.

— Po dhe mua më mban, — ma priti shoku im. — Hipi në çati, po qe nevoja.

— Jo në çati, — u hodha unë, — se thyen tjegullat e nënë Ishes.

— E di si them unë? — tha pas një heshetjeje Aliu.

— Hë?

— Ta presim telin në të dyja anët. Ti prite këtu, unë po e pres matanë, te muri i Kadriut.

Nuk ju përgjegja menjëherë. Fillova të mendohesha. Solla ndërmend këshillat e porositë që na kish dhënë shoku i partisë.

— Ç'ke që s'flet? — tha Aliu duke u munduar të më shohë në sy nëpër errësirë.

— Po ai, nuk tha kështu?

— Kush?

— Shoku Misto!

Pas kësaj, heshti dhe Aliu. Tani ishte errësuar fare. Hënë atë natë s'kish. Dritat e rrugeve i kishin hequr prej kohësh fashistët.


— Fatos, — tha me gjysëm zëri Aliu, — unë po shkoj. . .

Futi sharrën në gji dhe u hodh mbi mur. Kur dëgjova që zbriti matanë, zura të ngjitem në caracë. Ngjitesha si mace, në fillim kapesha me duar, pastaj shtyhesha përpjetë me këmbë. Gërshërët e ftohta më vrisnin në gjoks, po prapë s'doja t'ja dija.

Kur hipa sipër, qëndrova të mirrja veten. Isha djersitur, dhe këtë e ndjeva kur puhija e natës zuri të më freskonte. Ula kokën dhe vështrova poshtë meje. Kisha hipur pothuajse në majë. U ngrita në këmbë dhe mora frymë

me tërë gjoksin. Sa i bukur ishte ky aksion! Po gëzimi im sikur u pre, kur dëgjova këpuçët e rënda të një patrulle milicësh, që po kalonte nëpër rrugicë. U ula njëherë dhe qëndrova ashtu midis degëve gjersa patrulla e fashistëve humbi në kthesë. Për një çast, pandeha se mos na kishin kuptuar dhe vinin të na rrethonin. Krahërori më ngrihej e më ulej me të shpejtë, fryma pothuajse më ngeli. Qëndrova ashtu një kohë, pastaj mblodha veten, nxora menjëherë gërshërët e zura t'i provoj nëpër duar. Duart më dridheshin. Sa inat më vinte! Sikur të ishte Aliu, do të qeshte me mua. Po shoku Misto ç'do të thoshte, po të më shihte në këtë gjendje? Më erdhi turp nga vetja. Shtrëngova fort gërshërët, sa më dhembti dora.

Teli kalonte sipër meje dhe humbiste pastaj nëpër degë. U ngrita dhe pak përpjetë dhe e kapa telin me dorë. Ai bënte zhurmë, dhe ngjante sikur herë kumbonte me uturimë, herë fishkëllonte. Kjo m'u duk një gjë tërheqëse, dhe më pëlqente të rrija ashtu disa çaste, po papritur dëgjova një zhurmë që erdhi nga kopshti i Kadriut. Pas kësaj, tringëlliti diçka në mur. Teli filloi të lëshohej nga krahu im. Kjo donte të thoshte se Aliu e kish kryer detyrën, kurse unë s'kisha filluar ende. Atë-



here, mbështeta mirë këmbët në një degë, ndërsa teli më ra në gjoks. U largova pak dhe e vura telin midis presave të gërshërës së madhe. Pastaj shtrëngova me forcë dy duart në dorezat, por, papritur, gërshëra m'u anua e rrëshqiti, dhe trupi im e humbi drejtpeshimin, e desh u rrëzova. Degët u lëkundën me zhurmë në qetësinë e natës. Kësaj here nuk më erdhi frikë, po inat dhe, ashtu siç isha, e vura telin prapë në gërshërë dhe shtrëngova duart deri sa më dhembën. Megjithatë, teli nuk desh t'ja dinte. Atëhere, përdora peshën e gjithë trupit për t'ju ndihmuar duarve. Po teli rrëshqiste, dhe më dukej sikur e gjithë caraca lëkundej. E prapë s'doja t'ja dija: qëndroja sipër telit gjithë zemërim, sikur të kisha vënë poshtë ndonjë fashist dhe përpiqesha ta mundja. Teli, si duket, ishte i fortë. Nga inati, unë shaja herë pas here duke pëshpëritur gjithë duf: «Fashisti i dreqit!»

Pas shumë mundimet, teli u këput dhe unë rashë sipër degëve të caracës. Dëgjova që teli rrëshqiti poshtë. Më vinte të thërrisja nga gëzimi. Vështrova nën vete, dhe syri më kapi telin që vezullonte turbull në errësi. Kur e pashë ashtu, nuk më erdhi më ta shaja. U zvarrisa poshtë si mace dhe veç kur shkela telin me këmbë. Pastaj, nisa ta mbledh rrotullame.

Në fillim e tërhiqja me lehtësi, por, pas pak, ai u rëndua dhe mezi tërhiqej, deri sa erdhi e ngeci. Mendova se do të ish ngatërruar në ndonjë pemë në kopshtin e Kadriut. Thashë ta prisja aty ku kish ngecur, mbasi rrotullamja ishte bërë goxha e trashë, por më erdhi keq t'ua lija fashistëve. Atëhere, mora rrotullamen e telit në krahë dhe u ngjita me këmbë e me duar në mur. Kur hipa sipër, pushë poshtë në kopsht një hije që lëvizte nëpër bar.

Nuk u përmbajta dhe thirra me zë të ulët:

— Kush je ti?

— Mos thirrë ashtu! — dëgjova zërin e Aliut. Atëhere e kuptova pse ishte rënduar teli dhe, ashtu siç isha, u hodha nga muri, poshtë në kopsht.

— Ngadalë se më shkele telin, — më tha Aliu që po e mblidhte dhe ai nëpër bar. Unë nuk durova, po ju hodha në qafë dhe i tregova pastaj rrotullamen time. Ai vazhdonte të mblidhte telin pa u shqetësuar nga gëzimi im i vullshëm. Kur mbaroi punë, i bashkoi të dyja rrotullamet dhe më tha:

— Bjere thesin!

Pastaj futëm telin në thes dhe u nisëm për në shtëpinë e dajës së Aliut.

Të nesërmen mbas dreke, shkua me sho-ku Misto. Ai na priti buzagaz dhe, me atë zërin e tij të qetë, na tha:

— E shokë, si shkoi puna?

Ne e shikonim drejt e në sy, me një krenari të përmbajtur. S'dinim si ta shprehnim me fjalë atë që kishim bërë.

— Mirë, shoku Misto! Porosinë e Partisë e kryem, — tha Aliu.

— Ju doli ndonjë pengesë?

Unë thashë:

— Kur e premë, jo, po kur e mblodhëm. . . Shoku Misto u vrejt në fytyrë.

— Çfarë mblodhët, more?

— Telin, — thamë të dy me një gojë.

Ai u afrua dhe thirri i habitur:

— Telin?! Po ç'kini bërë kështu! Kush ju tha ta mblidhnit telin e të vinit jetën në rrezik?

Ne ulëm kokën, dhe unë, për veten time, nuk dija si t'i përgjigjesha, kurse Aliu, pas pak, tha:

— Të prisje telin, shoku Misto, nuk është ndonjë gjë e madhe!

— Ju kaq duhej të bënit. Kaq kërkonte Partia prej jush, — foli ai me një zë të prerë, sa unë e kuptova menjëherë se kishim bërë gabim të madh. Bile dhe Aliu nuk fliste, dhe kjo tregonte se edhe ai e quante veten fajtor si unë. Ne rrinim në heshtje, kokulur, sytë i kishim me lot, ndërsa shoku Misto ndezi një

cigare dhe zuri të lëvizë poshtë e përpjetë.

Mua më vinte inat që gjithë ai gëzim ishte shndërruar tani në një dëshpërim të thellë.

Shoku Misto qëndroi në vend dhe na u afrua të dyve, me një pamje serioze:

— Ju nuk e dini se mbrëmë, me urdhër të Partisë, janë prerë telat e armikut në gjithë Shqipërinë. Po sikur t'ju shikonin fashistët me telin në krahë?

— Ne e kishim futur në thes, — u hodha unë.

Ai bëri sikur nuk i dëgjoi fjalët e mia. Përsëri ra një heshtje e padurueshme. Më vinte inat me Aliun që s'fliste dhe rrinte si dru. Po përgjegjësi ynë, sikur ta kuptonte gjendjen tonë, e ndërroi bisedën dhe na pyeti nëse kishim fjetur mbrëmë dhe si do t'i justifikonim mungesat në shkollë.

Para se të largoheshim, Aliu nxori që brenda këmishës disa monedha të lagura nga djersa dhe ja zgjati shokut Misto.

— Po këto, ç'janë? — hapi sytë shoku Misto.

— Paret e telit, — u hodha unë për t'i ardhur në ndihmë shokut tim, që i ishte lidhur gjuha. — Shkuam në pazar dhe e shitëm...

— Si, e shitët telin?! — tha ai i habitur,

ndërsa mua më dhembti përbrenda, duke kujtuar se mos kishim bërë ndonjë gabim tjetër.

— Dëshëm ta çonim në Pezë te partizanët e Babë Myslimit, — shpjegoi Aliu me zë të dredhur, — po ishte larg e s'shkonim dot. . .

— E pastaj? — pyeti prapë ai.

— I sollëm këto që t'ja jepni Partisë, shoku Misto, — tha Aliu dhe ja la paratë në dorë, nga frika se mos nuk pranonte t'i merrte.

Shoku Misto nuk e priste këtë gjë. Sytë i morën një shkëlqim të thellë. Donte të fliste e nuk fliste dot. I mbante buzët gjysëm të hapura e na vështronte si i hutuar. Pastaj, me të hollat në dorë, na rroku në qafë të dyve njëherësh.

— Faleminderit, djema! — tha ai.

Neve, padashur, na rodhën lotë faqeve.

UNË, BABI DHE SHOKËT E MI

Shtëpia jonë ndodhet në katin e pestë dhe, për të hipur gjer atje lart, unë ngjit nëntëdhjetetë shkallë. Gjyshit s'i pëlqen shtëpia jonë, osë, më mirë, kati ynë, prandaj ai nuk vjen shpesh te ne. Ai thotë se është më lehtë të hipësh në minare sesa të ngjitesh gjithato shkallë. Gjyshi ka të drejtë, sepse është plak dhe vuan nga reumatizma. Kurse mua, babit dhe mamit, na pëlqen shumë shtëpia atje ku e kemi. Bile, mami nuk do që t'ja shash katin. «Jemi për bukuri këtu lart; as pluhur, as zhurmë, si në majën e malit të Dajtit», thotë ajo. Këto fjalë i përsërit mami sa herë që ndonjë guxon t'i shajë katin. Po ndonjëherë dhe mamit s'i vjen mirë që e kemi shtëpinë në katin e pestë. Këtë e di vetëm unë. Kjo ndodh zakonisht në muajt e dimrit. Dhe kur, thoni ju? Kur vjen puna për të ngjitur drutë.

Sa herë që babi pret faturën e druve,

mami dhe babi rrinë në shtëpi mbasditeve. Mirëpo një ditë, kur erdhën drutë, ajo nuk u ndodh aty. Kishte vajtur te një shoqe e vet. Në shtëpi ishim vetëm unë e babi. Rrinim në kuzhinë. Babi po shkruante, se do të shkonte në një mbledhje, kurse unë vizatoja. Ishte qetësi e madhe. Vetëm zjarri, siç thotë gjyshi, bubullonte në sobë. Por, papritur e pakujtuar, trokiti dera. Dikush i ra derës disa herë me të madhe. «Kush i bie kaq fort?» thashë unë me vete, kurse babi e kuptoi dhe thirri:

— Janë drutë!

Unë lashë vizatimin dhe vrapova të hapja derën.

— Piçiruk, faturën e druve, — më tha një djalë i gjatë, me flokë kaçurela. Babi e dëgjoi prapa meje dhe ju përgjegj:

— Faturën jua jap unë, po mund të na ndihmoni pak?

Ai djali nuk priti e, duke ikur, ja bëri:

— Ne nuk ngjitim dru, po shikoni se janë disa djem poshtë. Ata mund t'jua ngjitin.

Babi nuk foli më. As mua s'më tha gjë, po u nis menjëherë të zbriste poshtë: I vajta pas dhe, duke zbritur shkallët, mendoja: «Si do t'ja bëjmë? Babin nuk e pret puna.»

Kur zbritëm poshtë, pamë në oborrin prapa pallatit tonë maqinën e druve dhe gjith-

ata fëmijë mbledhur përçark. Shoferi rrinte te timoni, me kokën të nxjerrë jashtë. Ai djali me flokë kaçurela shkarkonte drutë. Babi i dha shoferit faturën dhe u kthye pastaj nga unë, duke qeshur. Ai nuk më tha gjë, po unë e kuptova. Babi ishte në hall. Dëgjova kur i tha mamit, se në ora gjashtë kish mbledhje. Të prisnim mamin të vinte, apo t'i fillonim vetë? Babi nuk foli gjersa u shkarkuan drutë. Kur iku maqina, ai më tha:

— Tani forca, Enrik, t'i ngremë!

Unë i thashë Cenit:

— Ceni, hajde na ndihmo njëçikë!

— Babi i Enrikut, — tha Ceni, — do t'i ngjitësh drutë shpejt? Thuaj Ganiut.

Babi shikoi nga grumbulli i çunave dhe pyeti:

— Kush vjen të na ndihmojë pak?

Në fillim nuk foli asnjëri. Bënë sikur nuk dëgjuan. Mua më erdhi inat që nuk ua vunë veshin fjalëve të babit tim. Koçua hodhi topin përtokë dhe zuri të loste me të, gjasme nuk dëgjoi. Nja dy çuna, që nuk i njihja, ikën fare. Gjithë të tjerët s'flisnin, sikur ta kishin bërë me fjalë.

— Vij unë, babi i Enrikut, — u dëgjua papritur zëri i Artanit. Artani është djali i xhaxhi Taqos, fqinjit tonë.

— Jo ti, xhani i xhaxhit, se je i vogël e lodhesh, — tha babi dhe nxori paqetën e ndezi një cigare shpejt e shpejt. Babi vërtet kishte rënë në hall, dhe mua më vinte keq. Po më shumë më vinte inat me çunat. Disa nga ata ishin shokë të mi. Në vend që të rrinin ashtu kot, le të vinin të na ndihmonin. Me mendje thoshja: «Mirë, mirë, do të kini nevojë dhe ju ndonjë ditë, po ta shihni, po ju ndihmova!»

Babi hodhi cigaren dhe pyeti:

— Cili është Ganiu?

— Unë jam, — tha me zë të lartë Ganiu, që rrinte në mes të çunave.

— Si thua, do t'i ngjitem? — i tha babi me buzë në gaz.


— I ngjitem, po duam pesë lekë të reja.

Babi desh t'i thosh diçka, por nuk foli, veç mbaj mend që u vrejt në fytyrë. Mua më erdhi plasja, sepse me Ganiun kisha luajtur futboll, pastaj ishim në një shkollë. Unë nuk do ta bëja kurrë këtë. Po nuk i fola gjë, se babi i tha:

— Mirë, po vetëm do t'i ngjitësh?

— Jo, — ja priti Ganiu duke e parë babin në sy, — jemi plot. — Ai zuri të numërojë me gisht: — Një, dy, tre, katër... dhe unë!

Unë i njihja dhe të tjerët! Qenë Vaska,



Kadriu, Kozmai dhe Ademi. Ata ishin shokë të Ganiut dhe e dëgjonin atë për çdo gjë. Ata e donin Ganiun, se zinte gardalina me kafaze. Ai kishte shumë gardalina në shtëpi dhe i shitte me lekë. Kurse atyre që i kishte shokë, ua falte, nuk u merrte fare para. Shokët i binde-shin Ganiut, prandaj kur ai tha: «Hajdeni, çuna, t'i ngjitim», ata filluan menjëherë të ngrinin drutë. Babi u habit kur ata të katër ju bindën shokut të vet, po nuk foli. Filloi dhe ai të marrë dru, dhe, pas tij, unë me Cenin. Kështu u bëmë gjithsej tetë vetë. Ja vinim drutë njëri-tjetrit në duar dhe ngjiteshim varg gjer lart. Babi merrte më shumë nga të gjithë. Pastaj vinte Ganiu. Ai ishte më i fortë dhe më i shpejtë nga të tërë ne. Babi, sa herë e ndeshte nëpër shkallë, e qortonte:

— Jo kaq, djalë i mbarë!

Po Ganiu nuk dëgjonte. Ai ngarkohej si kalë, gjer te hunda, dhe prapë nuk lodhej. Po dhe të tjerët punonin sa mundnin.

Më vinte çudi kur shihja se të gjithë i ngjitnin shkallët të gëzuar, sikur të ngrinin drutë e veta e jo tonat. Secili mundohej t'ja kalonte tjetrit dhe secilit ja kishte qejfi ta shihte të ngarkuar babi im. Babi u buzëqeshte të gjithëve, u përkëdhelte kokën, ose thoshte: «Rriti, mos merr më, se je djersitur shumë». Ai

mbylli gjithë dritaret e shkallëve që të mos na binte era kur ngjiteshim lart.

Kur i ngjitëm të gjitha drutë, babi i futi të gjithë çunat në dhomë dhe vetë shkoi në kuzhinë. Ata u ulën nëpër karrike dhe në divanin e madh, kurse unë qëndrova në këmbë, afër derës. Isha shumë i gëzuar, sepse asnjëherë nuk më kishin ardhur në shtëpi kaq shokë. Ata shikonin bibliotekën dhe fotografitë nëpër mure dhe, me sa dukej, u pëlqente shtëpia ime.

Ganiu pa fotografinë e madhe varur në mur dhe më pyeti:

— Po ky, kush është?

— Gjyshi! — i thashë.

— Gjyshi! — thirri ai. — E paske patur king gjyshin.

Mua më erdhi mirë që Ganiu ma lavdëroi gjyshin, dhe desha t'i thoshja se tashti gjyshi është plakur dhe s'është më king, siç ka qenë, po ma mori fjalën Kozmai:

— Ne s'kemi fare fotografi të gjyshit, — tha ai.

— Gjyshi im ka qenë partizan, — tha Kadriu. — Ne kemi një fotografi të tij, ku ka dalë me xhaxhi Enverin.

Kështu, të gjithë zunë të flasin për gjyshërit e vet, duke treguar se ç'ka qenë njeri

dhe ç'ka qenë tjetri. Unë bëja ç'bëja dhe shikoja gjyshin tim, në mur. Atë ditë po më pëlqente sa asnjëherë tjetër.

Kur hyri në dhomë babi, ne e ndërpremë bisedën për gjyshërit. Ai ishte i qeshur, dhe unë kisha qejf ta shikoja gjithnjë ashtu.

— E, — pyeti ai, — u lodhët ca?

— Jo, — ja priti menjëherë Ganiu, — jemi çapajevë ne!

— Ju faleminderit — tha babi.

Ai kish marrë me vete kupën e karamelave dhe ma zgjati mua:

— Na, jepu shokëve. Merrni nga dy secili.

Babi shkoi prapë në kuzhinë dhe, kur u kthye, u ndau të gjithëve nga një grusht arra.

Çunat i merrnin arrat si me turp dhe thoshin: «Faleminderit!» Vetëm Ganiu nuk pati gajle, e pa babin në sy dhe, shpejt e shpejt, provoi të thyejë një arrë me dhëmbë.

— Qenkan gunga, dreqkat! — thirri Ganiu.

— Jo me dhëmbë, se të prishen! — e këshilloi babi.

— Ku pyesin dhëmbët e mi! I kam çelik unë!

Babi nuk bisedoi më për dhëmbët e arrat, dhe fjalët e fundit të Ganiut bëri sikur nuk i dëgjoi. Unë e di se, kur babi nuk të vë veshin,

kjo do të thotë se atij nuk i pëlqen ajo që thua. Prandaj ai e la Ganiun dhe filloi të bisedonte me çunat e tjerë. Babi i pyeti me radhë se të kujt ishin dhe në ç'klasë mësonin. Në fund, ai tha:

— Kjo punë që bëtë sot është për t'u lavdëruar. Ju lumtë! Unë do të dëshiroja që këtë gjë ta vazhdonit. Pallati ynë ka nevojë dhe për ndihmën tuaj. Ti, Enrik, — më tha ai, — që sot e tutje u je borxhli të gjithë këtyre. Dëgjuat, mos kini turp! Sa herë t'ju vijnë drutë, thërritni dhe Enrikun.

Kur tha babi kështu, unë ula kokën dhe nuk fola, sepse të gjithë shikonin nga unë. Pas kësaj, u bë një pushim që mua m'u duk orë. Nuk flisnin as babi, as çunat. Unë shikoja me bisht të syrit.

— Xhaxhi Leka! — ky ishte zëri i Vaskës, që rrinte afër meje, dhe babi sa e dëgjoji, ktheu kokën. — Ne nuk i duam lekët.. Ne nuk deshëm...

Vaska nuk e mbaroi fjalën, sepse diçka e shtrëngoi në grykë. Të gjithë sa ishim në dhomë, kthyem kokën nga ai. Vaska kishte ulur sytë, dhe qepallat i dukeshin si të kolisura. Unë pashë nga babi, mos ish habitur dhe ai si të gjithë ne të tjerët nga fjalët e Vaskës. Ai nuk tha gjë, po, ashtu siç foli pastaj,, as me të qe-

shur, as me seriozitet, donte të thoshte se dhe babin e kish çuditur Vaska.

— Ju lumtë djem! — tha babi. — Kështu veprojnë pionierët. Punët e mira as blihen, as shiten me para.

Babi fliste, dhe sytë i mbante nga Ganiu. Ganiu, si dëgjoi këto fjalë, uli kokën, po unë i vija re mirë sytë e tij të hapur dhe nofullat e shtrënguara. Mua se si më vinte ashtu, kur e shihja Ganiu! Më vinte edhe keq, edhe mirë. Nuk e kisha parë ndonjëherë ta ulte kokën, aq më tepër në sy të të gjithë atyre çunave. Papritur, më kapi një frikë e madhe. Thashë me vete: «Kush e di se ç'do të bëjë ky tani!» Mund të shante shokët, po mund të hidhte arrat te këmbët e mia dhe të ikte me vrap.

Unë pashë nga babi dhe vura re se ai ishte vrejtur në fytyrë. Kjo donte të thoshte se dhe babi e ndjente veten ngushtë si unë.


— Gani, — tha babi, — ngrije kokën dhe ti si shokët.

Ganiu e ngriti menjëherë kokën. Unë mora frymë i lehtësuar. Atë kohë, dëgjova Kadriun që tha:

— Xhaxhi, as Ganiu nuk i do paratë...

Të gjithë çunat shikuan nga Ganiu. Ai, për çudi nuk e uli kokën, por, papritur, nga sytë e tij rrodhën lot. Mua më erdhi shumë

keq, dhe jo vetëm mua, po të gjithëve. Ganiun nuk e kisha parë kurrë të qante dhe doja që



kjo gjë të kalonte sa më shpejt.

Ne rrinim të gjithë si të hutuar. Asnjëri nuk dinte se ç'do të bëhej më tej. Tërë shpresën e kisha te babi. Në këtë kohë, babi i qe afruar bibliotekës dhe kish marrë një libër në dorë.

— Gani! — tha babi duke i zgjatur librin.
— Dua të të jap këtë libër si dhuratë për të kujtuar ditën e sotme. Nuk besoj që shokëve të tu t'u vijë keq, që ta jap ty. Zëre se ua kam dhënë të gjithëve, apo jo djema?

— S'ka gajle, s'ka gajle! — ja bënë të tjerët, gati me një zë, të gëzuar që çdo gjë po përfundonte aq bukur.

Pastaj babi shtoi:

— Këtë libër të mrekullueshëm e ka shkruar një shkrimtar shumë i dashur për fëmijët, Arkadi Gajdar quhet.

Ganiu mori librin dhe e shtrëngoi në gjoks. Ai rrinte pa lëvizur, si i ngrirë. Ne e shikonim atë libër nga larg, sikur të mos kishim parë ndonjëherë libër me sy. Babi qëndronte në këmbë, me fytyrë të qeshur.

Nuk kaloi shumë, dhe çunat u ngritën. I pari u ngrit Vaska:

— Ne do të ikim tani, xhaxhi Leka.

— Si të keni qejf, — tha babi dhe i zgja-

ti dorën. Pastaj u dha dorën të gjithëve me radhë, duke i thënë secilit «Faleminderit!»

Dorën ua jepja dhe unë, po më vinte për të qeshur, se ata ishin shokët e mi dhe ne s'ishim mësuar t'i jepnim ashtu dorën njëri-tjetrit.

Pasi ikën çunat, babi u vesh e shkoi në mbledhje, ndërsa unë ju vura punës. Kjo ishte hera e parë që i vendosja vetë drutë në depo dhe fshija koridorin. Kështu, kur erdhi mami, nuk kish mbetur asnjë punë pa u bërë.

ARTILJERËT E VEGJËL

Unë them të shkojmë, çuna! — tha i vendosur Aliu dhe vështroi nga shokët, që ishin ndalur në mes të rrugës.

— Po sikur të mos na lërë roja? — u hodh Skënderi.

— Pse të mos na lërë roja? — ja priti Novruzi, që po kafshonte një fije bari me dhëmbë. — Ne do t'i themi se kemi ardhur të urojmë për festën.

— Unë njoh Petron, atë ushtarin e gjatë që lot me top, — tha Fatmiri. — Kushedi, mund të jetë ai roje!

— Të kërkojmë komisarín, — foli prapë Novruzi. — Ai ka ardhur në shtëpinë tonë.

— Hajde, shkojmë, — ja bëri Aliu, komandanti i çetës dhe filloi të ecë vetë i pari. — Hajde se nuk do të na thonë gjë.

Djemtë shkuan pas Aliut, pa bërë fjalë, duke ngjitur rrugën që merrte përpjetë ko-

drës. Të katër shokët e kishin bërë me fjalë që më përpara dhe, kur mbaruan orët e mësimt u takuan në oborrin e shkollës. Shkolla e fshatit të tyre ishte fqinjë me një repart të vogël ushtarak. Ajo ngrihej në rrëzë të kodrës, kurse reparti ishte vendosur sipër, në majë. Fëmijët kishin qejf të miqësoheshin me ushtarët dhe, kur një ditë më parë Aliu u tha shokëve se kish dëgjuar nga babai që të nesërmen artilierët kishin festë, ata kishin vendosur të shkonin të gjithë së bashku në repart.

Tani djemtë kishin ngjitur gjysmën e rrugës së përpjetë. Atje larg dukeshin ndërtesat e vogla të repartit. Ata ecnin njëri pas tjetrit, dhe në ballë printe gjithnjë Aliu.

Kur dolën në majë të kodrës, panë rojen që rrinte me pushkë mbi sup në të hyrë të repartit, dhe i ngadalësuan hapat.


Aliu ktheu kokën dhe vuri re se shokët qenë shkëputur prej tij.

— Ecni njëçikë, — tha Aliu, — se kushedi ç'thotë roja.

Djemtë e vegjël prisnin që t'u thërriste që nga larg «ndal», po ai i vuri re dhe i la të afroheshin.

Ata vinin ngadalë, të ndruajtur, dhe vetëm Aliu guxonte të shikonte rojen.

Roja lëvizti nga vendi, kurse ata qëndruan.



Ai thirri: — Ndal! — E kur ata u ndalën ai i pyeti:

— Hë, djema, ç'doni?

Aliu bëri disa hapa drejt tij e tha:

— Duam komisararin!

— Ç'e doni komisararin?

Aliu mbeti një çast dhe uli kokën.

— Sot ju kini festë dhe ne erdhëm...

Rojes i qeshi fytyra dhe tundi kokën. Pas-taj thirri:

— Përgjegjësi i ndërresës!

Para syve të fëmijëve doli një ushtar i gjatë dhe seç bisedoi me rojen.

— Kini për ta parë, po nuk na tha ikni!

— Pëshpëriti Skënderi.

— Thua ti ashtu, — ja bëri Novruzi.

— Afrohuni, çuna! — tha Aliu kur pa që ushtari i gjatë vrapoi për nga ndërtesat e repartit.

Roja thirri:

— Afrohuni, se tani vjen komisari!

Djemve u shkëlqyen sytë, dhe shkuan pas Aliut.

Ata e kuptuan se ai që po vinte që komisari, megjithëse nuk e njihnin. Edhe Novruzi që e njihnte, nuk arriti të thotë gjë, sepse oficeri u drejtua me hap të shpejtë nga djemtë dhe u tha:

— Hajdeni, hajdeni! Mos kini turp. Ky është reparti juaj.

Të parit, komisari ja zgjati dorën Aliut dhe pastaj të tjerëve me radhë, duke u thënë:

— Mirseardhët, mirseardhët!

Komisari i çoi fëmijët në një dhomë, që ngjante me klasën e tyre, veçse, në vend të bangave, kishte tavolina e karrige. Ajo ishte zbukuruar plot hijeshi, aqsa atyre u mbetën sytë një kohë nëpër mure.

Aty gjetën disa ushtarë, të cilët u ngritën menjherë në këmbë dhe u dhanë dorën mysafirëve.

— Sa mirë bëtë që erdhët! — tha komisari kur të gjithë u ulën nëpër karrige. — Kujt i shkoi mendja për këtë?

Të gjithë panë nga Aliu, dhe komisari, që ishte afër tij, i shtrëngoi krahun:

— Të lumtë!

— Neve na vinte pak turp, — u hodh e tha Novruzi duke parë oficerin në sy.

— E pse të kishit turp? — tha komisari.

— Ne erdhëm t'ju urojmë për festën e artilerisë! — u dëgjua zëri i mbytur i Skënderit.

— Faleminderit! — tha komisari.

Dalëngadalë, fëmijëve u iku turpi dhe filluan të bisedonin lirisht. Komisar i pyeti për

shkollën, për prindërit. Pastaj secili bisedonte me ushtarët që kish afër.

— Kush do të bëhet artiljer nga ju? — pyeti komisari.

— Unë! — tha i pari Aliu.

— Edhe unë! — shtoi Novruzi.

— Mua më pëlqen shumë topi, — foli me zë të lartë Fatmiri, që s'kish folur deri atëhere.

— Po ti? — e pyeti një ushtar Skënderin, që s'po bënte zë.

Të gjithë kthyen kokën nga Skënderi.

— Vërtet, po ti? — ja bëri komisari.

Skënderi uli kokën.

— Atij i pëlqen pushka, — shpjegoi Aliu.

— Ashtu? — pyeti komisari.

— Po, — tha Skënderi, — pushka është më e mirë se topi.

Ushtarët qeshën, qeshën dhe djemtë me komisarin.

— Ky dashka t'u bëka këmbësor! — tha një ushtar. Skënderi uli kokën.

— Të dyja janë të nevojshme për të luftuar armikun.

— Xhaxhi komisar, — tha papritur Skënderi, — po partizanët nuk kanë luftuar më shumë me pushkë?

— Po, — tha oficeri, — me pushkë kanë luftuar.

— Pse s'kanë pasur topa? — u hodhën të tjerët të gjithë së bashku.

— Kanë pasur, posi, po më pak.

— Po tanksa kishin? — pyeti Novruzi.

— Tanksa jo, — tha komisari duke buzëqeshur.

— As aeroplana? — pyeti Fatmiri.

Dhoma e repartit jehoi nga gazi i të gjithëve dhe vetëm kur bëri me dorë komisari, ata pushuan.


— Partizanët s'kanë patur as tanksa, — tha ai, — as aeroplana, as topa të mëdhenj, po prapë dinin ta mundnin armikun, që i kish të gjitha. Nuk është puna aq te armët sesa te njerëzit. Ai që ka në zemër dashurinë për atdheun e vet, ai ka armën më të fortë, që mund çdo armik!

Të gjithë dëgjonin komisarin. Ai fliste bukur, kish një zë të ëmbël dhe dukej sikur i fliste secilit.

— Tani, hajdeni t'ju tregojmë shtëpinë tonë, — tha ai në fund.

Fëmijë dhe ushtarë bashkë, të zënë për krahu, u ngritën e dolën jashtë, në sheshin e repartit. Atyre se si u vinte ashtu që u bënë inq ndërsa kudo që shkonin!

Pasi vizituan të gjitha me radhë, fjetoren,



mencën, ata mezi prisnin të shikonin armët e artiljerëve.

Sa herë i kishin parë nga larg grykat e topave, që ngriheshin drejt qiellit! Dhe sa dëshirë kishin t'i shikonin nga afër!

Tani ata qenë pranë tyre, i shikonin tek vetëtinin, i preknin me dorë, u lëviznin instrumentët, dëgjonin fjalët e ushtarëve.

— Ky është topi im! — i tha Novruzi Aliut, me zë të ulët.

— Pse s'thua yni? — ja priti Aliu.

— Si the? — pyeti komisari.

— Ne duam të mësojmë topin, — tha Aliu më në fund, duke shikuar nga shokët, që heshtën papritur. — Në gazetë kemi lexuar për fëmijët e qytetit, që kanë qëlluar me top.

— Edhe ju do ta mësoni, — tha komisari, — po me një kusht: do të bëhen artiljerë vetëm ata që shkojnë mirë me mësim.

Djemtë sa nuk ju hodhën në qafë oficerit. Vetëm Fatmiri uli kokën. Komisari e vuri re, po nuk bëri zë. As të tjerët nuk thanë gjë për shokun e tyre.

— Ne, — ja bëri Aliu, — do të jemi edhe nxënës edhe ushtarë të mirë.

— Vetëm duhet të pranoni një gabim, — tha komisari.

Fëmijët hapën sytë. Ushtarët që rrinin përçark, buzëqeshën.

Komisari i hodhi një vështrim serioz Aliut e tha:

— Ushtarë sot nuk janë vetëm djemtë, po dhe vajzat.

Djemtë panë njëri-tjetrin në sy. Vetëm Aliu vazhdonte të shihte oficerin dhe, kur ai mbaroi, tha:

— Shoku komisar, ne ju premtojmë se herën tjetër do të vijmë bashkë me shoqet!

Kështu mori fund vizita e parë e fëmijëve në repart.

Të nesërmen, komisar, bashkë me komandantin, oficer Perlatin, shkuan në shkollë dhe, pas disa ditësh, një grup djemsh e vajzash ju ngjit kodrës duke kënduar.

Ata i ndanë në skuadra dhe secilës skuadër i dhanë nga një top të vogël.

Ndërkaq, filloi stërvitja. Djemtë e vajzat mësonin të fshehtat e armës, bënin prova, lëviznin instrumentët, drejtonin topin.

Stërvitja vazhdoi me javë e me muaj të tërë, deri sa erdhi dita e qitjeve.

Kjo ishte një ditë gëzimi për të gjithë.

U mblodh i tërë fshati në fushën që quhej poligon. Erdhën prindërit, vëllezërit, motrat, mësuesit dhe shokët e tyre ushtarë.

Artiljerët e vegjël qëndronin pranë armëve dhe prisnin urdhër. Komisari i shikonte dhe u buzëqeshte.

U dëgjuan komandat dhe, fill pas tyre, zërat e artiljerëve të vegjël.

Qielli jehoi, toka u tund, dhe predhat e zjarra fluturuan në vendet e caktuara.

Pastaj u bë heshtje. Të gjithë prisnin përfundimet, kur vendi kumboi nga thirrjet e gëzuara të fëmijëve.

Artiljerët e vegjël kishin qëlluar në she-një.

Armiku që asgjësuar.

Komisari dhe fëmijët përqafoheshin të mallëngjyer.

F214 LL

LIBRARY

PËRMBAJTJA

Tomka	3
Porosia e Partisë	18
Unë, babi dhe shokët e mi	35
Artiljerët e vegjël	48

LIBRARY

1952